

URDHËR
Nr. 616, datë 9.11.2020

PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDË VENDIT
(ndryshuar me urdhrin nr. 660, datë 2.12.2020)

Në mbështetje të nenit 7, pika 4, germat “d”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga *Coronavirus* i ri nr. 5005, datë 9.11.2020, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 22:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, *deri në një urdhër të dytë*.
 2. Përfshirje nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri bëhet për personat që duhet të lëvizin për emergjencë shëndetësore, motive pune apo nevoja të domosdoshme. Personat që lëvizin për arsye pune apo arsye të domosdoshme pajisen me autorizimin përmes portalit *e-Albania*.
 3. Personeli i shëndetësisë, punonjësit e strukturave të shërbimeve kritike, përfshihen nga rregulli i aplikimit në portalin *e-Albania*, duke pasur dokumentacionin që vërteton punësimin pranë institucioneve.
 4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative, sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet më datë 11.11.2020.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu